



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 18/07/2022 Ref.: 945/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës (GZ. Nr.07/01 mars 2019), Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (GZ. Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018) dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 101-të, të mbajtur më 30.06.2022, mori:

V E N D I M

- I. **Nuk akreditohet** programi i studimit të Universitetit “Fehmi Agani” në Gjakovë.
 1. *Albanologji, MA*, 120 ECTS
- II. Institucioni i Arsimit të Lartë si në pikën I, mbanë përgjegjësi ligjore për moszbatim të këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Universiteti “Fehmi Agani” në afatin ligjor, ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit, me stafin akademik si në tabelë;

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Albanologji, MA</i> , 120 ECTS Akreditim	Mimoza Hasani Pllana Sazan Kryeziu

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit Arlind Farizi në Universitetin “Fahmi Agani” në Gjakovë. Vizita është organizuar me datën 29.04.2022.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportin e vlerësimit, për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit dhe ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit *Albanologji MA 120 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht dy (2) standarde dhe pjesërisht pesë (5) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e 101 të mbajtur me datë 30.06.2022 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit “Fehmi Agani” në Gjakovë dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditë nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit “Fehmi Agani” në Gjakovë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Ass. Dr. Hasnija Iljazović
Kryetare e Këshillit Shtetëror